



FEDERATA E BADMINTONIT E KOSOVËS
BADMINTON SAVEZ KOSOVO
BADMINTON FEDERATION OF KOSOVO
Tel&Fax+ 383 132 917 +383-44-211-434;
Shtëpia e sporteve Rr.“Agim Ramadani” pn, 10000 Prishtinë
www.badminton-ks.org, email:b.f.kosovo@gmail.com

RREGULLORE PËR REGJISTRIMIN E KLUBEVE, SPORTISTËVE DHE TRAJNERËVE TË BADMINTONIT

202~~52~~

Federata e Badmintonit e Kosovës - Email: b.f.kosovo@gmail.com, - Tel + 383– 44 132-917

Në bazë të nenit 7 paragrafi 1 dhe nenit 15 paragrafi 2.1 të Statutit të Federatës së Badmintonit të Kosovës Kuvendi i Federatës së badmintonit në mbledhjen e vetë të mbajtur në Shtëpinë e Sporteve në Prishtinë të datës ~~05.11.2022~~ 26.03.2025 nxjerr:

REGULLORE PËR LICENCIMIN E KLUBEVE, SPORTISTËVE DHE TRAJNEREVE TË BADMINTONIT

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë Rregullore, rregullohet mënyra dhe kushtet për regjistrimin e klubeve të Badmintonit dhe të anëtarëve të tyre, e drejta e paraqitjes, licencat e lojtarëve, fuzionimi-bashkimi i klubeve, trajnereve, fshirja nga regjistri, puna e Komisionit për regjistrim, mënyra e mbajtjes së evidencës, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për regjistrim.

Neni 2.

Me aktin e regjistrimit klubet dhe anëtarët e tyre e fitojnë të drejtën për t'u paraqitur në garat e Badmintonit, në stinorin garues për të cilin janë regjistruar. Lojtari, i cili nuk është regjistruar në B.F.K, nuk mund të paraqitet në çfarëdo gare që është në kompetencë të B.F.K. përveç lojtarëve shtetas të Kosovës, të cilët janë të regjistruar në klubet e jashtme dhe të cilët sipas dispozitave të B.F. K. mund të paraqiten për përzgjedhjen e Kosovës. Kohëzgjatjen e stinorit garues e cakton Bordi Ekzekutiv i B.F.K.

Neni 3.

Regjistrimin formal të klubeve dhe të anëtarëve të tyre e bënë komisioni për regjistrim i B.F.K. Propozimin e komisionit për regjistrim të klubeve dhe lojtarëve fillimisht e aprovon formalisht Bordi ekzekutiv, e pastaj miratimi final bëhet nga Kuvendi me shumicë të thjeshtë të anëtarëve prezent në Kuvend.

Regjistrimi bëhet në kohën pas përfundimit të stinorit garues afat të cilin e përcakton Bordi Ekzekutiv. Përgjashtimisht, gjatë tërë vitit garues, mund të bëhet ripërtëritja e regjistrimit dhe regjistrimi i parë i lojtarëve për grup moshën e juniorëve dhe kadetëve. Juniorët e regjistruar pas afatit për regjistrim mund të marrin pjesë në gara vetjake por jo edhe ekipore.

Neni 4.

Me rastin e paraqitjes së kërkesës për regjistrimin e klubeve dhe të anëtarëve të tyre, si dhe për vazhdimin e regjistrimit paguhet taksa e regjistrimit, e cila është e ardhur burimore e B.F.K. Lartësinë e taksës së regjistrimit e cakton Bordi Ekzekutiv i B.F.K.

Neni 5.

Klubet munden, që me ekipet dhe lojtarët e tyre, të paraqiten vetë nëse e kanë regjistrimin e rregullt për atë stinor garues, gjë që e dëshmojnë me dokumentet e vërtetuara. Për çdo lojtar të regjistruar lëshohet vërtetimi librezë e garave, në të cilën shënohet data e regjistrimit, përkatësisht ripërtëritjes së regjistrimit dhe datën kur lojtari i caktuar e fiton të drejtën për të luajtur. Vërtetimi garues nuk është i vlefshëm pa kontrollimin e mjekut.

II. REGJISTRIMI I KLUBEVE

Neni 6.

Kërkesën për regjistrim ose për ripërtëritjen e regjistrimit, klubi ia parashtron Komisionit për regjistrim të B.F.K. në dy kopje. Kërkesa për regjistrim ose për ripërtëritjen e regjistrimit duhet të përmbajë patjetër: Emrin e klubit, vendin dhe adresën e selisë së klubit, emrin, adresën dhe numrin e telefonit të personave përgjegjës (Kryetari, sekretari) dhe personave të autorizuar për kontakte me B.F.K.

Neni 7.

1. Për regjistrimin e parë të klubit është e nevojshme të ~~bëhen~~plotësohen:

1.1. ~~•~~ Aplikacioni për anëtarësim me obligim të pranimit të veprimit në pajtim me statutin e ~~FPPKBFK~~-së, me Rregulloret dhe vendimet e organeve të ~~FPPKBFK~~-së,

1.2. ~~•~~ Certifikata apo kopja e noterizuar e regjistrimit të OJQ-së ose certifikatën e biznesit si shpk apo sha

1.3. ~~•~~ Certifikata apo kopja e noterizuar e Numrit Fiskal

1.4. Vërtetimi / vendimi për regjistrimin e klubit në komunën përkatëse

1.5. Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga ATK-ja

1.6. Dëshminë që klubi i përmbush kushtet për t'u marrë me veprimtari sportive të përcaktuar me Ligjin mbi sportin. Posedimi i infrastrukturës optimale për ushtrimin e veprimtarisë sportive të klubit

1.7. ~~•~~ Akti i themelimit, si dhe lista e anëtarëve të kuvendit me së paku pesëmbëdhjetë (15) persona fizik të moshës madhore (mbi 18 vj.) ~~me së paku pesëmbëdhjetë (15) persona fizik të moshës madhore (mbi 18 vj.)~~

1.8. ~~•~~ Statuti i klubit / shoqatës me vulë dhe nënshkrim

1.9. Listën e anëtarëve në detyrat udhëheqëse

1.9.1. ~~•~~ Përfaqësuesi i autorizuar i klubit / shoqatës nga Departamenti për OJQ

1.9.2. një person dhe anëtarët e familjes së tij të ngushtë që përfshijnë bashkëshortin, bashkëshortin jashtëmartesorë, prindërit dhe fëmijët, nuk mund të jenë pjesë e organeve qeverisëse e as të jenë aksionarë në vlerë prej më shumë se një (1) % të të gjithë kapitalit në dy ose më shumë klube të ~~pingpongut~~badmintonit.

~~• Vërtetimi / vendimi për regjistrimin e klubit në komunën përkatëse të klubit ose trajnerë, duke përfshirë edhe kontratën në mes sportistit profesionist dhe klubit~~

1.10.1. Kontrollet shëndetësore për të gjithë sportistët,

1.10.1.1. Në trajnim dhe garë sportive mund të marrë pjesë vetëm sportisti për të cilin është e vërtetuar aftësia shëndetësore.

1.10.1.2. Kontrolli shëndetësor bëhet nga institucionet e licencuara të nivelit sekondar apo terciar shëndetësor nga fusha e mjekësisë sportive. kontrollin shëndetësor të sportistit të zhvilluar në një shtet tjetër

1.10.2. ~~•~~ Kopjet e njohimit ose certifikatës lindëse sportistëve Dokument identifikues personal i lojtarëve

1.10.3. Fletë lëshimin nga klubi i deritashëm për sportistët nën moshën 21 vjeçare

~~• Listën e anëtarëve në detyrat udhëheqëse dhe listën e trajnerëve kushtet ligjore si në vijim:~~

- 1.11.1. ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare;
- 1.11.2. plotëson njërën nga këto kushte:
 - 1.11.2.1. ka diplomë përkatëse universitare të edukimit fizik;
 - 1.11.2.2. ka diplomë ose certifikatë të vlefshme për trajner në përputhje me nivelin përkatës të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, të lëshuar nga një institucion i akredituar nga agjencitë përkatëse në Republikën e Kosovës; ose
 - 1.11.2.3. ka licensë për trajner të lëshuar nga një institucion i akredituar jashtë Republikës së Kosovës.
- 1.11.3. Nuk e ka të ndaluar ushtrimin e veprimtarisë sportive sipas ligjit të sportit
- 1.12. —Të gjitha këto në formë elektronike kur BFK-ja të ofrojë një platformë digjitale

Neni 8.

- 1. Çdo vit klubi duhet ta bëjë ri-regjistrimin. Për ri-regjistrimit të klubi duhet plotësuar:
 - 1.1 Aplikacioni për vazhdimin e anëtarësisë.
 - 1.2 Aplikacioni për regjistrimin e së paku 6 sportistëve të cilët nuk janë udhëheqës të klubit ose trajnerë, duke përfshirë edhe kontratën në mes sportistit profesionist dhe klubit
 - 1.1.1 Kontrollat shëndetësore për të gjithë sportistët,
 - 1.2.1.1 Në trajnim dhe garë sportive të sportit të organizuar mund të marrë pjesë vetëm sportisti për të cilin është e vërtetuar aftësia shëndetësore.
 - 1.2.1.2 Kontrolli shëndetësor sipas këtij neni bëhet nga institucionet e licencuara të nivelit sekondar apo terciar shëndetësor nga fusha e mjekësisë sportive, kontrollin shëndetësor të sportistit të zhvilluar në një shtet tjetër
 - 1.1.2 Kopjet e letërnjoftimit ose certifikatës së lindjes së sportistëve që regjistrohen për herë të parë.
 - 1.1.3 Fletë lëshimin nga klubi i deritashëm për sportistët nën moshën 21 vjeçare
 - 1.3 Aplikacionin për regjistrimin e trajnerit ose instruktorit i cili plotëson kushtet ligjore si në vijim:
 - 1.3.1 ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare;
 - 1.3.2 plotëson njërën nga këto kushte:
 - 1.3.2.1 ka diplomë përkatëse universitare të edukimit fizik;
 - 1.3.2.2 ka diplomë ose certifikatë të vlefshme për trajner në përputhje me nivelin përkatës të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, të lëshuar nga një institucion i akredituar nga agjencitë përkatëse në Republikën e Kosovës; ose
 - 1.3.2.3 ka licensë për trajner të lëshuar nga një institucion i akredituar jashtë Republikës së Kosovës.

1.3.3 nuk e ka të ndaluar ushtrimin e veprimtarisë sportive sipas ligjit të sportit

1.4 Plotësimin e dokumentacionit nga neni 7 nëse ka mungesa

~~Të gjitha këto në formë elektronike kur BFK të ofrojë një platformë digjitale.~~

~~Çdo vit klubi duhet ta vazhdojë regjistrimin. Për vazhdimin e regjistrimit të klubit bëhet:~~

Neni 9.

Komisioni për regjistrim është i obliguar që brenda 15 ditëve nga data e pranimi të kërkesës ta bëjë regjistrimin. Nëse regjistrimi nuk është bërë, Komisioni për regjistrim është i obliguar që ta informojë klubin në afat prej 15 ditëve nga data e pranimi të kërkesës, për arsyet e mospranimi të regjistrimit.

Neni 10.

Klubi, përkatësisht lojtari janë të obliguar, që në afat prej 7 ditësh nga marrja e vendimit pozitiv të Komisionit për regjistrim, ta paguajnë taksën e caktuar për regjistrim (dhe për vazhdim të regjistrimit). Klubi përkatësisht lojtari (nëse ka të bëjë me regjistrimin e mëvonshëm individual) nuk kanë të drejtë të lojës derisa të mos e paguajnë taksën për regjistrim. Nëse obligimi i lartpërmendur nuk është plotësuar as në afatin prej 30 ditëve, do të konsiderohet se vendimi për regjistrimin e klubit, apo lojtarit as që është bërë, gjegjësisht që e tërë procedura as që ka filluar.

Neni 11.

Për të gjitha ndryshimet me rëndësi për regjistrim, të cilat janë bërë gjatë rrjedhës së stinorit garues, klubet janë të obliguara që ta informojnë Komisionin për regjistrim në afat prej 10 ditëve nga ndryshimi i bërë.

Neni 12.

Kur bëhet bashkimi i dy ose më shumë klubeve, klubi i porsaformuar regjistrohet në pajtim me dispozitat e nenit 7 të kësaj Rregulloreje. Klubi i krijuar në këtë mënyrë (me bashkim) nuk do të mund të regjistrohet derisa klubet që bashkohen të mos i kenë kryer të gjitha obligimet.

Neni 13.

Në rast të ndryshimit të emrit, klubi paraqet:

- Kërkesën për ndërrimin e emrit, duke shënuar emrin e vjetër dhe të riun,
- Vendimin e organit të klubit, i cili është kompetent për ndërrimin e emrit,
- Fotokopjen e vërtetuar mbi regjistrimin me emër të ri në regjistrin e departamentit të OJQ-së.

Neni 14.

Klubi, i cili për vitin rrjedhës nuk e bën regjistrimin nuk mund të paraqitet në asnjë nivel të garave që është në kompetencë të B.F.K.

Neni 15.

Klubi do të shlyhet nga evidenca e B.F.K. nëse nuk e dorëzon kërkesën për vazhdimin (ripërtëritjen) e regjistrimit në afat prej dy vjetësh nga data e regjistrimit të fundit.

III. REGJISTRIMI I GARUESVE

Neni 16.

Si garues mund të regjistrohen të gjithë shtetasit e Kosovës, të cilët janë anëtarë të njërit nga klubet e Badmintonit të Kosovës.

Nuk mund të regjistrohet personi i rritur, i cili nuk i ka të gjitha drejtat qytetare.

Me pajtimin e lidhjeve të tyre nacionale mund të regjistrohen edhe shtetasit e huaj anëtarë të klubeve të Badmintonit të Kosovës.

Vendimin për afatet për procedurën e regjistrimit për stinorin e ardhshëm e bien Bordi Ekzekutiv i B.F.K. në fillim të çdo viti rrjedhës.

a) Regjistrimi i parë

Neni 17.

- Me kërkesën për regjistrim të parë, Komisionit për regjistrim i dorëzohet:
- Deklarata e nënshkruar për anëtarësim në klub, (te personat e mitur me bashkë nënshkrimin e prindit-kujdestarit),
- Fotografia me madhësi 3x4 cm, jo më e vjetër se 6 muaj,
- Deklarata me shkrim se deri më tani nuk ka qenë i regjistruar,
- Dokumentin identifikues.

b) Ripërtëritja e regjistrimit

Neni 18.

Ripërtëritje e regjistrimit të garuesit llogaritet regjistrimi i serishëm për klubin e njëjtë për të cilin lojtari ka qenë i regjistruar në stinorin garues që i ka parapri stinorit për të cilin regjistrohet. Lojtari, i cili nga afati i caktuar me vendimin e Bordit Ekzekutiv të B.F.K në fillim të vitit paraprak, nuk paraqet në B.F.K. Fletëparaqitjen e nënshkruar për klub të ri automatikisht regjistrohet për klubin e deritashëm për stinorin e ardhshëm garues, përveç nëse lojtari nuk paraqet deklaraten për pushimin e anëtarësimit në klub.

Formatted: Left

Neni 19.

Kalimi i lojtarit nga klubi në klub bëhet në afatin kalimtar, të cilin në fillim të çdo stinori garues e cakton Bordi Ekzekutiv (sipas nenit 16.) deri kur kalimet duhet të jenë të përfunduara. Për të gjithë dokumentacionin lidhur me procedurën e regjistrimit që dërgohet me postë (vetëm rekomande) e vlefshme është data në vulën e postës, kurse për të tjerat që dërgohen personalisht data e protokollimit në B.F.K.

Neni 20.

Për çdo vit të ardhshëm garues lojtari i moshës mbi 21 vjeçare mund të nënshkruajë fletëkalimin për cilindo klub sipas dëshirës së tij pa fletëlëshimin e klubit të deritashëm. Të gjitha obligimet në relacionin klubi-lojtari zgjidhen me kontratën e ndërsjellë qytetar, në të cilën përcaktohet mënyra e angazhimit si dhe kushtet e ndërprerës së kontratës.

Neni 21.

1. Në rast se lojtari e nënshkruan fletëkalimin për më shumë klube, do të regjistrohet për klubin i cili e ka fletëkalimin me datën më të hershme, me ç'rast si e plotfuqishme merret data në vulën e postës me dërgesë rekomande B.F.K. apo data e protokollit nëse fletëkalimi është dërguar individualisht në B.F.K. Përgjashtim nga kjo mund të jetë vetëm marrëveshja, ndërmjet klubeve të interesuara dhe lojtarëve, e vërtetuar te protokolluesi publik.
2. Lojtarëve kosovarë të regjistruar në klubet kosovare iu mundësohet regjistrimi dhe pjesëmarrja edhe në ligat e shteteve tjera njëkohësisht, me kushtin që ata nuk mund të refuzojnë ftesën e Përfaqësueses për kampe, grumbullime apo gara

ndërkombëtare dhe nëse kjo ndodh atëherë rasti disiplinor inicohet nga Drejtori i Përfaqësueses apo Bordi Ekzekutiv në Komisionin Disiplinor

c)Regjistrimi i lojtarëve të huaj për klubet Kosovare

Neni 22.

Për t'u bërë regjistrimi i shtetasit të huaj për klubin e Kosovës Komisionit për regjistrim duhet t'i dorëzohet:

- Fletëkalimi i nënshkruar me dorë klubit për të cilin dëshiron të regjistrohet lojtari i caktuar deri në afatin e vërtetuar (sipas nenit 16) të kësaj Rregulloreje,
- Leja e Federatës së huaj nacionale, më së voni deri 1 korrik të vitit rrjedhës.

Neni 23.

Lojtari i huaj do të jetë i regjistruar për klubin e Kosovës edhe në rast se leja e federatës së huaj nacionale vjen edhe pas datës që e cakton bordi, por me të drejtë të paraqitjes për klubin vetëm pas 30 ditësh në garat ekipore e pas 15 ditësh në garat individuale.

Neni 24.

Lojtari i huaj, i cili e merr shtetësinë kosovare pas mbarimit të afatit kalimtar nuk ka të drejtë të paraqitet në garat që janë në kompetencë të B.F.K. gjatë stinorit rrjedhës garues dhe deri në fund të stinorit mund të bëjë gara vetëm si lojtar i "huaj". Klubi mund të ketë më shumë lojtarë të huaj të regjistruar, por të drejtë paraqitjeje në ndeshjen ekipore në kompetencë të B.F.K. ka vetëm një lojtar i huaj.

IV. KOMPENZIMI ME RASTIN E KALIMIT TË LOJTARIT NGA NJË KLUB NË TJETRIN

Neni 25.

Lojtarët, në Kosovë, mund të kalojnë nga klubi në klub lirisht çdo vit në afatin e caktuar kohor saktësisht, në pajtim me këtë Rregullore.

Neni 26.

BFK-ja e vërteton të drejtën e klubit që me rastin e kalimit të lojtarit të tij në klubin tjetër mundet të kërkojë dëmshpërblim për mjetet e investuara për zhvillimin e tyre derisa kanë qenë anëtarë të klubit në kategoritë e grup-moshave të reja. Dëmshpërblimi mund të kërkohej te secili kalim i lojtarëve deri U19 të cilët në klub kanë kaluar së paku dy vite dhe vetëm te kalimi i parë i lojtarit U21 nga klubi në të cilin i ka kaluar dy vitet e fundit si junior.

Klubi për të vërtetuar të drejtën e tij duhet të dorëzojë së bashku me kërkesën edhe kontratën e ndërsjellët me lojtarin përkatës

Neni 27.

Vlerat e dëmshpërblimit janë dhënë në tabelën e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje dhe është shprehur në pikë. Vlerën e pikës për afatin e përmendur kalimtar e cakton Bordi ekzekutiv i BFK-së në mbledhjen e tij njëkohësisht kur vendoset edhe për afatet e kalimit.

Ranglista	U15	U19	U21
E Kosovës			
1-5	800 €	1000 €	1200 €
6-10	400 €	500 €	600 €
11-20	200 €	250 €	300 €
E Evropës			
1-10	3000 €	6000 €	15000 €
11-20	1500 €	4000 €	10000 €
21-30	1000 €	3000 €	6000 €
30-50		2000 €	5000 €
51-100			3500 €

Nëse lojtari është lojtarë në më shumë kategori merret për bazë ranglista nga mosha momentale e lojtarit.

V. KALIMI I LOJTARËVE NË KLUBET E HUAJA

Neni 28.

Që një lojtar i Kosovës të mund ta marrë lejen nga BFK-ja për të luajtur në Botën e jashtme, duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të nënshkruajë kontratën për obligimet ndaj përzgjedhjes së Kosovës,
- Të ia paguajë dëmshpërblimin klubit nga i cili largohet sipas kushteve nga neni 26 dhe tabelës nga neni 27 i kësaj Rregulloreje.
- Të paguajë taksën në ~~FPFK-BFK-së~~ sipas tabelës së vërtetuar për taksë, e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

TAKSA E KALIMIT NË BOTËN E JASHTME

a) lojtarët të cilët kanë qenë në përbërje në garat ekipore për përzgjedhjen e të rriturve, së paku 2 herë në katër vitet e fundit	200 pikë
b) Lojtarët të cilët janë paraqitur për përzgjedhjen e Kosovës në garat vetjake, së paku 2 herë në katër vitet e fundit	100 pikë
c) Lojtarët të cilët kanë qenë në përbërje në garat ekipore për përzgjedhjen e kadetëve dhe të juniorëve në katër vitet e fundit	100 pikë
d) Të gjithë të tjerët	50 pikë

Vlerën e pikës e cakton Bordi ekzekutiv i BFK-së në fillim të vitit garues.

Neni 29.

Lojtari është i obliguar të paguajë taksën e vërtetuar çdo herë kur kalon nga klubi i Kosovës

në klubin e huaj, si dhe në rastet kur angazhohet njëkohësisht në ligat e BFK-së si dhe në ligat e shteteve tjera.

Neni 30.

Lojtarët e huaj që paraqiten për klubet e Kosovës nuk janë të obliguar t'i paguajnë BFK-së taksën për kalim në klubin e huaj.

Neni 28.

Regjistrimin e parë të trajnerave dhe të anëtarëve të tyre e bënë komisioni për regjistrim i B.F.K.. Regjistrimi bëhet në kohën pas përfundimit të stinorit garues afat të cilin e përcakton Bordi Ekzekutiv i B.F.K. Përjashtimisht, gjatë tërë vitit garues, mund të bëhet ripërtëritja e regjistrimit dhe regjistrimi i parë i trajnerave, ndersa kjo qështje do të rregullohet në detale pas formimit të shoqatës së trajnerave që do të jëtë në kuader të Federatës së Badmintonit të Kosovës.

VI. REGJISTRIMI I DYFISHTË

Neni 31.

Me qëllim të krijimit të mundësisë së përparimit më të shpejtë të lojtarëve të rinj (juniorëve dhe kadetëve) lejohet regjistrimi i dyfishtë i lojtarëve të kategorive të reja për klubin tjetër me të drejtë të paraqitjes për klubin e ri vetëm në kategorinë e të rriturve, kurse lojtari i njëjtë do ta mbante të drejtën për t'u paraqitur për klubin amë në kategoritë më të reja. Kohëzgjatja e regjistrimit të dyfishtë mund të kufizohet në një vit garues dhe duhet të ripërtërihet në afate të njëjta sikur çdo kalim tjetër.

Neni 32.

Klubi mund të ketë më shumë lojtarë me regjistrim të dyfishtë, por të drejtë paraqitjeje në ndeshje ekipore në kompetencë të ~~FPFK~~BFK-së ka vetëm një lojtar me regjistrim të dyfishtë.

VII. PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 33.

Kundër çdo vendimi të Komisionit për regjistrim mund të bëhet kërkesë për rishqyrtim të vendimit në afat 7 ditorë, për të cilën komisioni i regjistrimit shqyrton rastin së bashku me dokumentet shtesë në afat prej 7 ditësh.

Neni 34.

Ankesa në vendimin e Komisionit për regjistrim i parashtrohet komisionit të Apelit, si shkallëe dytë, në afat prej 30 ditësh nga dorëzimi zyrtar i vendimit të Komisionit për regjistrim. Komisioni i Apelit do ta zgjidhë ankesën në afat prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të ankesës.

Neni 35.

Ankesat e bëra pas afatit nga neni 34, do të konsiderohen të vjetërsuara. Vendimet e komisionit të apelit për të gjitha ankesat për procedurën e regjistrimit janë përfundimtare

VIII. E DREJTA PËR PARAQITJEN E EKIPI

Neni 36.

Lojtarët fitojnë të drejtën e paraqitjes në garat ekipore 7 ditë pas kryerjes së regjistrimit të rregullt kurse 3 ditë për garat individuale. Lojtari i regjistruar e merr librezën e garave me fotografinë personale, e cila duhet të jetë e tillë që në bazë të saj të mund të bëhet identifikimi i lojtarit.

Lojtari është i obliguar që para çdo gare t'ua tregojë librezën e garave personave zyrtarë.

Neni 37.

Në librezën e garave duhet të vihet vërtetimi për vizitën e bërë mjekësore. Vërtetimi nuk guxon të jetë më i vjetër se sa që është paraparë me Ligjin për sport.

IX. KOMISIONI PËR REGJISTRIM

Neni 38.

Bordi Ekzekutiv emëron Komisionin për regjistrim. Komisioni për regjistrim përbëhet nga tre (3) anëtarë dhe punon në mbledhje, në të cilat mbahet procesverbal. Mandati i komisionit zgjatë aq sa zgjat mandati i Bordit Ekzekutiv i cili e ka emëruar.

Neni 39 .

Komisioni për regjistrim:

- Bën regjistrimin e klubeve dhe të anëtarëve të tyre dhe për këtë lëshon dokumentacionin gjegjës sipas kësaj Rregulloreje:
- I zgjedh ankesat e shkallës së parë,
- E udhëheqë evidencimin e klubeve dhe lojtarëve,
- E jep pëlqimin për kalimin e lojtarëve në klubet e huaja,

Neni 40 .

Dokumentet e regjistrimit udhëhiqen nga parime të hapura, të sakta dhe të vërteta. Çdo klub dhe lojtar duhet ta ketë kartonin e tij, në të cilin shënohen të gjitha të dhënat relevante.

X. DISPOZITA PËRMBYLLËSE

Neni 41 .

Kjo rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit nga kryetari i BFK-së dhe e njejta publikohet në faqen zyrtare të BFK-së.

Prishtinë Më datë 26.03.2025.

Formatted: Left



~~Përfaqësues i autorizuar i BFK-së:~~

~~Prishtinë~~

~~Më datë 05.11.2022~~

~~Haziri, Kreytar~~

~~Lulzim~~

Federata e Badmintonit e Kosovës - Email: b.f.kosovo@gmail.com,- Tel + 383- 44 132-917

Formatted: Left

Formatted: Tab stops: 4.54", Left